

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **24 dhjetor 2014**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 26 dhjetor 2014 dhe zgjatë deri më 14 janar 2015.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4


Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullorja në fjalë për që si hartues dhe propozues i kësaj Draft-Rregulloreje të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Janar 2015.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **24 dhjetor 2014**, pas shqyrtimit të Draft-Planit Lokal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2015-2018, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft- Plani Lokal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Romë dhe Ashkali në Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2015-2018.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 26 dhjetor 2014 dhe zgjatë deri më 14 janar 2015.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Kryesuesi i Komisionit që si hartues dhe propozues i Draft-Plani në fjalë për që si hartues dhe propozues i këtij Draft-Plani të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu Kryesuesi i Komisionit obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Janar 2015.


Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 10 pika 1.4 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **24 dhjetor 2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME
KOMUNALE PËR KËSHILLIN E BASHKËSISË ISLAME NË VUSHTRRI

Neni 1

Me këtë Vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme komunale – pjesë nga parcela kadastrale nr.190, fletëtreguesi nr.204 në sipërfaqe prej 900 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2571 m², ZK Studime e Poshtme, e evidentuar në emër të PSH Komisioni për Komasicion.

Neni 2

Paluajtshmëria e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi i jepet në shfrytëzim pa kompensim në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve për Këshillin e Bashkësisë Islame në Vushtrri.

Neni 3

Nëse brenda afatit prej tre (3) viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi nuk fillon investimi, atëherë ndërpritet (humbet) e drejta e shfrytëzimit të parcelës sipas nenit 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 5

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: fleta poseduese, kopja planit dhe kërkesa e KBI-së nga Vushtrria.



Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Shpëtim Zhegrova


Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 “d” dhe nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 41.2 “ç” dhe nenin 55 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **24 dhjetor 2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01NR. 23/14, DT. 30.01.2014

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.23/14, dt.30.01.2014 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete me sa vijon:
Emërohet anëtare e Komitetit për Komunitete Javoroka Slavic në vend të Bratislav Kosticit.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit

